



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 71, datë 12.07.2022

PËR

MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR.4, RRUGA "TELAT NOGA", PALLATI NR.8, I DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me Ligjin nr. 97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.904, datë 24.12.2019 "Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit" i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.5, datë 06.01.2020 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model" i ndryshuar, Urdhërit nr.164, datë 01.07.2020 "Për ngritjen e komisionit të posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit", i ndryshuar, Raportit nr. 471/39 prot., datë 06.07.2022 si dhe relacionit përkatës hartuar nga Komisioni i Posaçëm, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit në Njësinë Administrative nr.4, Rruga "Telat Noga", Pallati nr.8, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e


tërmetit të datës 26 nëntor 2019, hartuar nga Komisioni i Posaçëm sipas “Aneksi 1. Subjektet përfituese të Pallatit nr.8, Rruga "Telat Noga", pjesë përbërëse e këtij vendimi.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Komisioni i Posaçëm dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 13.07.2022



ANEKSI 1. SUBJEKTET PËRFITUESE TË PALLATIT NR.8, RRUGA "TELAT NOGA"

Nr.	PRONARI	GJENDJE FAMILJARE SIPAS ÇERTIFIKATES	STRUKTURA E APARTAMENTIT QË DO PËRFITOHET
1	MEMUSH TROQE	7	3+1
2	SAMI XHYVELAJ, VIOLETA XHYVELAJ	6	3+1
3	MARJANA GOXHABASHI, THOMA GOXHABASHI, FIONA GOXHABASHI	2	1+1
4	BEKTASH GJONA, NURE GJONA, RAJMONDA GJONA, ARTUR GJONA	5	3+1
5	IKBALE CELEPIJA, SHABAN MURAT CELEPIJA, HAJRULLA CELEPIJA, BALLKIZE CELEPIJA, ARIAN CELEPIJA, ALMA CELEPIJA	5	3+1
6	EMINE HAXHIU, BUKURIJE HAXHIU, AVNI HAXHIU	4	2+1



BASHKIA DURRËS
20/7/22 Nr. 6051/5



REPUBLICA E SHQIPËRIE
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 570 prot.

Durrës, më 19.07.2022

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr. 71 datë 12.07.2022 Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit në Njesisnë Administrative Nr.4 Rr. "Telat Noga" Pall. Nr.8, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26.11.2019.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI
EMILJAN JANI**

